



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.46, datë 29.06. 2018

P Ë R

**“FILLIMIN E PROCEDIMIT ADMINISTRATIV PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES MIDIS SIPËRMARRËSIT ABCOM SH.P.K DHE GERANTINA
ZYLO, PERSON FIZIK (FASTNET)”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 29.06.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” shqyrtoi çështjen me objekt:

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis ABCom sh.p.k dhe Gerantina Zylo, person fizik (FASTNET)”

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Ligji nr.120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” (**ligji 120/2016**);

3. Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015);
4. Rregullore nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”;
5. Rregulloren nr.22, 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrejteve kabllore urbane dhe rrejteve me fibra optike ndërrbane”;
6. Rregulloren nr. 35, datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e ABCom me Nr 194 Prot, datë 05.06.2018, “Dërgohet Njoftimi për pranimin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes”;
- Deklaratë, datë 05.06.2018 e Shoqërisë “ABCom” sh.p.k;
- Shkresë e ABCom me nr. 70 Prot, datë 05.03.2018, “Lidhur me të drejtën e përdorimit të tubit nga Bashkia Korçë”.
- Shkresë e ABCom nr.149 Prot, datë 07.05.2018, “Njoftim për ndalimin e cënimit të integritetit fizik të rrjetit të komunikimit elektronik në pronësi të shoqërisë ABCom sh.p.k”;

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi ABCom sh.p.k me shkresën nr.194. Prot, datë 05.06.2018 (nr. 1717 Prot. Në AKEP, datë 06.06.2018) “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje lidhur me ndërhyrjet e paautorizuara në rrjet dhe infrastrukturën e ABCom sh.p.k, nga subjekti Gerantina Zylo (FASTNET)”, ka depozituar kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe subjekti Gerantina Zylo (FASTNET).
2. Me Deklaratën e datës 05.06.2018, sipërmarrësi ABCom sh.p.k. shprehet se ka bërë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur çështjen objekt mosmarrëveshje, nëpërmjet bisedimeve tregtare, të cilat sipas tyre kanë rezultuar pa sukses. Për shkak të pamundësisë së zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirëkuptim e bashkëpunim me subjektin tregtar person fizik Gerantina Zylo (me emër tregëtar FASTNET), në përputhje me përcaktimet e neneve 22 dhe 120 të Ligjit nr. 9918/2008, dhe të Rregullores nr.18, datë 11.06.2010 “Për

procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, shoqëria ABCCom i është drejtuar AKEP për adresimin dhe zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje.

3. Konkretisht, me shkresën nr. 70 Prot, datë 05.03.2018, *“Lidhur me të drejtën e përdorimit të tubit nga Bashkia Korçë”*, ABCCom sh.p.k. i ka kërkuar Bashkisë Korçë ndërhyrjen me qëllim mbrojtjen e infrastrukturës së rrejtit kabllor Fibër Optike, HFC Korçë, realizuar nga shoqëria ABCCom sh.p.k. në bazë të vendimit nr 44., datë 14.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë Korçë. ABCCom sh.p.k në zbatim të Lejes së ndërtimit nr.1181 prot., datë 19.05.2016, ka shtuar një tub me të njetat përmasa dhe karakteristika teknike në çdo kanalizim të hapur /të riparuar, i mbetur në përdorim të Bashkisë Korçë. Çdo ndërhyrje e paautorizuar në këtë tub sipas shqetësimit të ngritur nga ABCCom sh.p.k, mund të shkaktojë dëmë të konsiderueshme dhe me pasoja të rënda e të pariparueshme. Në këto kushte, sipërmarrësi në fjalë ka shprehur pretendimin se nëse do të ketë operatorë të tjerë të komunikimeve elektronike të cilët potencialisht do të fitojnë të drejtën e përdorimit të tubit të shtuar nga ABCCom kjo duhet të bëhet nëpërmjet një marrëveshje /kontrate që këta operatorë mund të nënshkruajnë me Bashkinë Korçë. ABCCom sh.p.k. i ka kërkuar më tej Bashkisë Korçë konkretisht:
 - a) Që të ndërtoje pusetat përkatëse, në mënyrë që aksesin në tubin në përdorim të saj të mos realizohet nga infrastruktura e rrjetit të ABCCom sh.p.k;
 - b) Nëse Bashkia Korçë kryen veprime juridike me të tretë sipas të cilave kalohen të drejta mbi tubin, pas ndërtimit të pusetave, duhet gjithashtu të:
 - i. të verifikojë paraprakisht, nëse sipërmarrësi është i pajisur me autorizimin nga AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
 - ii. të respektojë parashikimet e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 *“Për mbrojtjen e konkurrencës”* i ndryshuar duke garantuar që nënshkrimi i veprimit juridik nuk shkakton si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike në qytetin e Korçës. Në fund ABCCom shton se çdo tub nga të tretët nëpërmjet infrastrukturës së rrjetit të ABCCom , duhet të autorizohet dhe miratohet nga shoqëria ABCCom, jo vetëm në cilësinë e pronarit të rrjetit, por edhe në zbatim të legjislacionit të komunikimeve elektronike.???
4. Me shkresën nr.149 Prot, datë 07.05.2018, *“Njoftim për ndalimin e cënimit të integritetit fizik të rrjetit të komunikimit elektronik në pronësi të shoqërisë ABCCom sh.p.k”*, Znj.Gerantina Zylo (FASTNET) është informuar nga sipërmarrësi Abcom sh.p.k., mbi shqetësimin e tyre lidhur me cënimin e integritetit fizik të rrjetit të komunikimit elektronik në mënyrë të kundraligjshme dhe të paautorizuar, pasi në rrjetin e tyre ka vendosur një pajisje pasive rrjeti (xhunto) në puseten në pronësi të ABCCom sh.p.k. e ndodhur në kryqëzimin e shëtitorës “Fan Noli” dhe Rrugës “10 Korriku” në Korçë. ABCCom sh.p.k. i ka kërkuar sipërmarrësit FASTNET që të ndërpresin menjëherë këtë cënim të paligjshëm të pronësisë, si dhe marrjen e masave për vendosjen e rrjetit në gjendjen e mëparshme brenda një afati të caktuar kohor nga marrja e njoftimit në fjalë.
5. Sipërmarrësi ABCCom sh.p.k, në kërkesën e paraqitur me shkresën me nr.194 Prot, datë 05.06.2018 (nr. 1717 Prot., i AKEP,datë 06.06.2018) *“Kërkesë për zgjidhje*

mosmarrëveshje lidhur me ndërhyrjet e paautorizuara në rrjet dhe infrastrukturën e ABCom sh.p.k, nga subjekti Gerantina Zylo (FASTNET)”, i kërkon AKEP:

- **Zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve me qëllim arritjen e marrëveshjes për mënyrën e përdorimit të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve dhe pagesën përkatëse.**
- 6. Drejtoria Juridike dhe e Integritimit pasi shqyrtoi kushtet formale të kërkesës së paraqitur nga sipërmarrësi Abcom sh.p.k. gjykon se “Kërkesa për zgjidhje mosmarrëveshje” nga ana e ABCom sh.p.k është paraqitur sipas kushteve formale-juridike të parashikuar në Rregulloren nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”. Gjithashtu objekti i mosmarrëveshjes, për të cilin AKEP është investuar, është brenda kompetencës lëndore të tij sipas parashikimeve në Rregulloren nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, Rregulloren nr. 35, datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike”, Rregulloren nr. 22, datë datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrejteve kablore urbane dhe rrejteve me fibra optike ndërrurbane”.
- 7. Duke qenë se sipërmarrësit ABCom sh.p.k. dhe FASTNET, megjithë përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis tyre, në zbatim të nenit 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, AKEP zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar Ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 114, neni 115 si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**) neni 130 e në vijim,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedimit administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Gerantina Zylo, person fizik (FASTNET);
2. Të ngrihet Komisioni për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara në Rregulloren nr.18, datë 11.6.2010.
3. Të njoftohen palët e interesuara ABCom sh.p.k dhe Gerantina Zylo, person fizik (FASTNET);
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij.

K R Y E T A R

Ilir Zela

ANËTARË:

- | | | |
|------------------------|-----------------|---------------|
| 1. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 2. Znj. Edlira | Dvorani | Anëtar |
| 3. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 4. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |